



SHOQERIA "LIRENG AUDITING" SH.P.K

Adresa: Rruga "Dibres" Pall.324/1 Tirane

Email: lireng.auditing@gmail.com

Tel/Fax: +355 42 450 952

Mob: 0672079155

RAPORT I AUDITUESIT TE PAVARUR

**PER AUDITIMIN E PASQYRAVE FINANCIARE
TE AKTIVITETIT TE KOMITETIT OLIMPIK KOMBETAR SHQIPTAR
PER PERIUDHEN 01.01.2013-31.12.2013**

KOMITETIT OLIMPIK KOMBETAR SHQIPTAR

T I R A N E

TE NDERUAR ZOTERINJ!

Ne ekzekutimin e misionit qe na eshte besuar, kemi audituar Pasqyrat Financiare te "Komitetit Olimpik Kombetar Shqiptar"(OJF), te cilat perfshijne pasqyrimin financiar per periudhen 1 Janar - 31 Dhjetor 2013 te sintetizuar ne Bilancin Kontabel te dates 31 Dhjetor 2013, pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve, pasqyren e flukseve te parase, pasqyren e ndryshimeve ne kapital si dhe nje permbledhje te metodave kontabel me te rendesishme dhe shenime te tjera anekse qe shoqerojne keto pasqyra.

Drejtimi i entitetit eshte pergjegjes per pergatitjen dhe paraqitjen e pershtatshme e te sinqerte te ketyre Pasqyrave Financiare ne perputhje me Standartet Kombetare te Kontabilitetit.

Kjo pergjegjesi perfshin;hartimin, venien ne zbatim dhe mbajtjen e kontrollit te brendshem te pershtatshem per pergatitjen dhe paraqitjen e sinqerte te ketyre pasqyrave financiare pa anomali materiale te shkaktuara nga mashtrimi ose gabimi; zgjedhjen dhe zbatimin e metodave te pershtatshme kontabel, si dhe kryerjen e çmuarjeve kontabel qe jane te aresyeshme per rrethanat e dhena.

Pergjegjesia e shoqerise tone audituese eshte qe te shprehim nje opinion per keto pasqyra financiare bazuar ne auditimin e kryer. Auditimi i kryer nga ana e jone u be ne perputhje me Standartet Nderkombetare te Auditimit. Keto standarte kerkojne qe ne te zbatojme kerkesat e etikes dhe te planifikojme e te kryejme auditimin me qellimin, per te marre siguri te arsyeshme nese Pasqyrat Financiare jane pa anomali materiale.

Auditimi perfshiu;

- kryerjen e procedurave per te mare evidence auditimi rreth shumave dhe informacioneve te dhena ne pasqyrat financiare.Procedurat e zgjedhura varen prej gjykimit te audituesit, duke perfshire vleresimin e rreziqeve per anomali materiale ne pasqyrat financiare, qofte per shkak te mashtrimit ose te gabimit.

- Ne berjen e ketyre vleresimeve te rrezikut, audituesi merr ne konsiderate kontrollin e brendshem perkates te entitetit ne pergatitjen dhe paraqitjen me sinqeritet te pasqyrave financiare ne menyre qe te hartoje procedurat e auditimit qe jane te pershtatshme per rrethanat perkatese te entitetit, por jo per qellimin e shprehjes se opinionit per efektivitetin e kontrollit te brendshem te entitetit.
- Auditimi gjithashtu perfshin vleresimin e pershtatshmerise se metodave kontabel te perdorura dhe llogjiken e çmuarjeve kontabel te bere nga drejtimi me vecorite specifike te saj, si dhe per vleresimin e paraqitjes se pergjithshme te pasqyrave financiare.
- Ne besojme se evidenca e auditimit qe kemi marre eshte e mjaftueshme dhe e pershtatshme per te dhene bazat e opinionit tone te auditimit.

Sipas opinionit tone, Pasqyrat Financiare te Komitetit Olimpik Kombetar Shqiptar japin nje pamje te vertete dhe te sinqerte te gjendjes financiare per periudhen ushtrimore Janar - Dhjetor 2013, dhe performancen e saj financiare ne perputhje me Standartet Kombetare te Kontabilitetit.

Audituesi

“LIRENG Auditing” Sh.p.k

Neshat MAZE (Ekspert Kontabel i Regjistruar)

Administrator

Tirane, Prill 2013



PASQYRA E GJENDJES SE FONDEVE TE KOMITETIT OLIMPIK KOMBETAR SHQIPTAR

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2013	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2012
GJENDJA	18,872,547.24	5,344,147.30
SHUMA	18,872,547.24	5,344,147.30

PASQYRA E KRIJIMIT TE FONDEVE TE KOMITETIT OLIMPIK KOMBETAR SHQIPTAR

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2013	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2012
TE ARDHURAT	37,067,641.39	63,376,119.50
Te ardhurat nga Komiteti Olimpik Nderkombetar e SO	15,361,295.77	34,098,555.23
Te ardhurat nga Komiteti Olimpik European	10,562,125.11	9,199,371.50
Te ardhurat nga buxheti i shtetit	4,222,461.00	8,027,891.00
Te ardhurat nga sponsorizime vendas	2,339,406.42	6,931,972.72
Te ardhurat nga anetaresimet	444,000.00	85,000.00
Te ardhura te tjera	4,138,353.09	5,033,329.05
SHUMA	37,067,641.39	63,376,119.50

PASQYRA E PERDORIMIT TE FONDEVE TE KOMITETIT OLIMPIK KOMBETAR SHQIPTAR

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2013	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2012
SHPENZIMET		
Bursa Olimpik "Sochi 2014"	2,326,869.00	4,938,140.94
Asistence Federatave dhe Shoqatave	4,319,624.49	5,696,513.49
Mobilje Paisje dhe Mjete te tjera Invetari	653,180.51	739,643.78
Shpenzime per akomodim dhe dieta	6,929,236.10	8,245,061.72
Shpenzime transporti	5,015,330.19	3,502,202.49
Shpenzime per materiale	1,735,668.93	5,228,186.63
Shpenzime postare dhe telefonike	1,023,356.28	1,139,259.92
Shpenzime karburanti	314,181.80	294,606.00
Shpenzime per energji elektrike	202,569.60	267,345.60
Shpenzime per qira	124,644.08	435,949.16
Shpenzime per mirembajtje	152,925.00	201,000.00
Shpenzime per honorare (përfshirë tatimi)	3,493,219.15	3,495,226.50
Shpenzime per paga, sigurime, tatime	5,960,756.00	6,432,933.00
Shpenzime Publikimi dhe Promovimi	966,886.15	1,864,876.25
Shpenzime te tjera	4,111,967.98	5,608,642.08
SHUMA	37,330,415.26	48,089,587.56

PASQYRA E KTHIMIT TE FONDEVE NE BUXHETIN E SHTETIT

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2013	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2012
KTHYER NE BUXHET	484,371.00	1,758,132.00
SHUMA	484,371.00	1,758,132.00

PASQYRA E GJENDJES SE FONDEVE TE KOMITETIT OLIMPIK KOMBETAR SHQIPTAR

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2013	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2012
GJENDJA	18,125,402.37	18,872,547.24
SHUMA	18,125,402.37	18,872,547.24

Audituesi

"LIRENG Auditing" Sh.p.k

Neshat MAZE (Ekspert Kontabel i Regjistruar)
Administrator

Tirane, Prill 2013

